



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 125/prot.
AF

Tiranë, më 16.12.2022

VENDIM

Nr. 934, Datë 16.12.2022

“PËR RRËZIMIN E ANKIMIT TË NDËRMARRJES STAR PARKING ALBANIA SHPK ME OBJEKT “KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT NR. 921, DATË 09.11.2022 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN STAR PARKING ALBANIA SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ankimi i ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK me objekt “Kundërshtimin e Vendimit nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”.

Bazë ligjore: Nenet 130-146 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; Neni 24, germa (d) dhe neni 46 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka depozituar shkresën datë 18.11.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 125/15 prot., datë 30.11.2022), me objekt: “Kundërshtimin e vendimit nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në

Konkurrencës nr. 921/2022, me pretendimin se konkluzioni që ka çuar Komisionin e Konkurrencës në gjobitjen e saj është “tërësisht i pamotivuar, joligjor dhe arbitrar”.

2. Nga vlerësimi në tërësi i shkresës së ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, rezulton se bëhet fjalë për një ankesë ndaj Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”. Me anë të këtij vendimi, Komisioni vendosi:
 - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).*
 - II. *Gjobitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 1,614,899 (një milion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë.*
 - III. *Miratimin e angazhimeve të depozituar nga ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë vijon:*
 - a) *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit;*
 - b) *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër;*
 - c) *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.*
 - IV. *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht:*
 - a) *vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
 - b) *kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
 - c) *zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
 - d) *vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*
 - V. *Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltetin përkatës.*
 - VI. *Për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare.*
3. Në ankimin administrativ, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka vendosur si bazë ligjore nenin 130 e vijues të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ku parashikohet ankimi administrativ ndaj aktit administrativ.
4. Bazuar në nenin 136/2 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pas pranimit të ankimit, organi publik kompetent shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e

aktit administrativ të ankimuar.

5. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën, (vetëm) kur përmbushet të paktën njëri nga 3 (tre) kushtet e përcaktuara në këtë nen:
 - a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
 - b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
6. Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, është një ligj i përforcuar dhe në respekt të neneve 81 e 116 të Kushtetutës dhe të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese ka përparësi në rast *antinomie* ndaj çdo ligji të thjeshtë (*lex superiori, inferiori derogat*). Sidoqoftë, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se nuk ka asnjë përplasje mes këtij legjislacioni superior dhe ligjit të tij organik (si *lex specialis*) dhe se dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në këtë rast gjejnë zbatim në vijim e plotësim të njëra tjetrës.
7. Nga Ankimi, nuk rezulton se ankuesi pretendon paligjshmërinë e Vendimit nr. 921, datë 09.11.2022 të Komisioni i Konkurrencës (KK) për shkaqe që lidhen me mungesën hipotetike të kompetencës së KK apo shkelje të dispozitave të procedurës administrative e, aq më pak me dispozitat që rregullojnë formën apo elementë të detyrueshëm të aktit administrativ.
8. Pretendimet thelbësore të ankuesit konsistojnë në faktin se:
 - a) procesi është realizuar tej afateve ligjore,
 - b) vlera e gjobës tejkalon kapitalin e shoqërisë.
9. Në lidhje me pretendimin “a”, Komisioni sqaron se periudha 6 mujore e hetimit rezulton të jetë respektuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës. Kjo periudhë ka përfunduar brenda afatit dhe në vlerësimin e tij për të arritur në vendimin nr. 921, datë 09.11.2022 Komisioni nuk ka marrë asnjë informacion, rrethanë a provë të siguruar jashtë kësaj periudhe. Marrja e vendimit, si në çdo rast tjetër, do të ishte pas përfundimit të periudhës hetimore dhe data 09.11.2022 ka të bëjë vetëm me veprimtarinë e brendshme të mbingarkuar të Autoritetit të Konkurrencës e nuk ka asnjë lidhje logjike me konceptin e paligjshmërisë të parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative.
10. Në lidhje me pretendimin “b”, Komisioni sqaron se, në bazë të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas Pjesës VI “Kundërvajtjet Administrative dhe Sanksionet”, KK vendos gjoba si përqindje mbi xhiron totale të vitit paraardhës financiar dhe legjislatori nuk ka vlerësuar që kjo vendimmarrje të ketë lidhje me ndonjë analizë rreth kapitalit të shoqërisë. Sidoqoftë, vlera e gjobës në rastin në fjalë është nga më të ultat që KK ka aplikuar ndonjëherë dhe plotësisht proporcionale dhe e bazuar në rrethanat e faktit dhe legjislacion.
11. Përsa i përket nenit 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

germa (a) “njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar”, KK vlerëson se nuk ndodhemi para këtij rasti, pasi asnjë nga faktet për dhënien e vendimit nuk kanë ndryshuar. Pala as e pretendoi këtë.

Referuar nenit 46, germa (b) “palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim”, nuk ndodhemi përpara këtij rasti, pasi as arsyetimi e as sanksioni nuk kanë lidhje me kushte apo detyrime të shkelura.

Referuar nenit 46, germa (c) “vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit”, KK gjithashtu vlerëson se nuk ndodhemi përpara këtij rasti, madje, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK gjatë procedurave hetimore nuk ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës informacion të plotë dhe të saktë, në përgjigje të kërkesave të Autoritetit të Konkurrencës, duke bërë të pamundur që të realizohen procedurat hetimore sipas ligjit nr. 9121/2003. Ka qenë pikërisht për këto arsye që Komisioni Konkurrencës në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ka vendosur të gjobisë ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK.





PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), dhe nenin 46, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Rrëzimin e ankimit të ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK me objekt “Kundërshtimin e Vendimit nr. 921, datë 09.11.2022 të Komisionit të Konkurrencës “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Adriana BERBERI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

